



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:300897

Datë: 22.01.2025

Numri i dokumentit: 06743673

C.nr.937/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K, Prishtinë, kundër të paditurve: 1. Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Shëndetësisë – QKMF “Dr. Fahredin Hoti”, në Rahovec, dhe 2. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPAP), të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë, Avokatura Shtetërore, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimi në emër të shtesave në pagë – shujtat mujore, vlera e objektit të kontestit 869.44 euro, jashtë seancës, me datë 22.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses D.K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohen të paditurat: 1. Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Shëndetësisë – QKMF “Dr. Fahredin Hoti”, në Rahovec, dhe 2. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPAP), me seli në Prishtinë që paditëses D.K, në emër të kompensimit të shtesave në pagë – shpenzimeve të ushqimit/shujtave ditore në punë për periudhën prej 06.02.2023 deri me 30.08.2024 t’ia paguajë për secilin muaj nga 45.76 euro, për 19 muaj, apo në shumën e përgjithshme shumën prej 869.44 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data e dorëzimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës të saj, me datë 03.09.2024 ka paraqitur padi ndaj të paditurave për kompensimin në emër të shtesave në pagë – shujtat mujore. Në padi ka theksuar se paditëses që nga data 06.02.2023, kur ka hyrë në fuqi Ligji për Paga në Sektorin Publik, Nr.08/L-196, i është ndërprerë shtesa në pagë/shujtat mujore, siç parashihet në Deklaratën e Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, Nr.122/08, të datës 16.10.08 dhe Vendimin nr.05/24, të datës 12.01.2018 i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e drektë kjo e fituar në bazë të Kontratës së Punës. Me tej ka shtuar se paditësja vlerëson se me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me nr. ref:

AGJ 2316/24, i datës 23.01.2024, duhet ti njihet e drejta për shtesën në pagë/shujta pasi që ky Aktgjykim në dispozitivin nr. VII, faqe 113-të, ka shpallë të pavlefshme nenin 45 par.2 të këtij ligji i cili përjashton shtesat në pagë/shujtat mujore e tjera, përveç atyre të njohura me Ligjin e Pagave. Duke shtuar se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e legjitimon kërkesën e paditëses në emër të shtesës në pagë/shujtës mujore. Gjykatës i ka propozuar që ta që ta detyrojë të paditurat që paditëses në emër të kompensimit të shtesave në pagë – shpenzimeve të ushqimit/shujtave ditore në punë për periudhën prej 06.02.2023 deri me 30.08.2024 t’ia paguajë për secilin muaj nga 45.76 euro, për 19 muaj, apo në shumën e përgjithshme shumën prej 869.44 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data e dorëzimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura e parë Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Shëndetësisë në përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, në mungesë të legjitimitetit real pasiv në këtë çështje kontestimore. Padia është e pathemeltë dhe pa bazë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – DSHPS. Më tej ka shtura se në bazë të shkresave të lëndës vërtetohet se paditësja nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë të rregullt administrative, pranë të paditurës. Gjykata mund të shqyrtojë një padi që ka elemente nga kontesti i mardhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt administrative pranë të paditurës si organ administrativë. Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

E paditura e dytë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBA), në përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa lejuar. Duke shtuar se MPBAP-së, i mungon legjitimitetit real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë. Me tej ka shtuar se Komunitat e kanë Kodin e vetë buxhetor. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar në mungesë të legjitimitetit real pasiv.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor mbi refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses pa caktuar fare seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 dhe 2 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës i rezulton se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie të punës me të paditurën në bazë të kontratës së punës me nr. protokollin 280/2022, ku rezulton se paditësja D.K është e sistemuar në pozitën

Infermiere në Qendrën e Mjekësisë Familjare “Dr. Fahredin Hoti”, në Rahovec. Lidhur me pagën bazë të paditëses, gjykata gjen se nga lista e pagave të buxhetit të Kosovës të bashkëngjitura në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja realizon pagë bazë 594.00 euro.

Fakti vendimtar për tu vërtetuar nga ana e Gjykatës në këtë çështje juridike kontestimore, konsiston në vlerësimin e faktit nëse paditëses i takon kompensimi në emër të kompensimit të shtesave në pagë – shpenzimeve të ushqimit/shujtave ditore në punë për periudhën prej 06.02.2023 deri me 30.08.2024 t’ia paguajë për secilin muaj nga 45.76 euro, për 19 muaj, apo në shumën e përgjithshme shumën prej 869.44 euro.

Çështja e kompensimit për pagesën e shujtave ditore, gjykata gjen se kërkesa e paditëses mbështetet në Deklaratën e Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës të datës 14.10.2008. Nga vlerësimi i kësaj deklarate, gjykata konstaton se kjo deklaratë nuk ka fuqinë e aktit ligjor apo nënligjor dhe nuk paraqet dokument detyrues për të paditurën. Kjo nënkupton se, pavarësisht marrëveshjes mes palëve të përfshira, Deklarata nuk ka kaluar procesin e nevojshëm të miratimit ligjor dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret si një dokument ligjërish detyrues. Gjykata, duke vlerësuar bazën juridike të kërkesëpadisë, konstaton se çdo pretendim për kompensim duhet të mbështetet në një bazë të vlefshme juridike, dhe së këndejmi të paditurat nuk mund të detyrohen të përmbushin një kërkesë mbi bazën e një deklarate që nuk ka peshën e një akti ligjor apo nënligjor të miratuar sipas procedurës përkatëse. Për më tepër Ligji për pagat në sektorin publik në nenin 30 [Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor] dhe në nenin 33 [Shtesa funksionale për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor] ka përcaktuar shtesat për nëpunësit e sistemit shëndetësor dhe, njëkohësisht ka përcaktuar edhe kushtet për përfitimin e këtyre shtesave, e që për pasojë, gjykata ka konstatuar se shtesa e pretenduar për shujta nuk hyn në kategorinë e këtyre shtesave.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e paditëses se me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2, 3 dhe 4 i nenit 41 (shtesa tranzitore) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi) i Ligjit për pagat në sektorin publik dhe mbi këtë bazë paditëses i takon e drejta në kompensim të shujtës ditore. Megjithatë, duke qenë se kërkesa e paditëses nuk mbështetet në një akt ligjor apo nënligjor por në një deklaratë e cila, - për arsyet që u elaboruan më lartë, u konstatua se nuk prodhon efekte juridike -, gjykata një pretendim të tillë e vlerëson si të pabazuar.

Andaj, për arsyet e dhëna në këtë aktgjykim, pasi që gjykata ka konstatuar se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 143.1 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2024:300897
Datë: 22.01.2025
Numri i dokumentit: 06743673

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.937/2024, më datën 22.01.2025

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.